



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:249700
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05048974

C-IV-14-0293

Ankuesi

L K, rr.Serbi.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 05 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI065-0543, datë 18 dhjetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 16 janar 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë (në dorëshkrim) kundër Vendimit nr. GJI065-0543, të datës 18 dhjetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 20,000.00 € për një periudhë të pacaktuar kohore, nga NSH “Vinex” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ka kërkuar kompensim për paga të papaguara për periudhën prill 1999 deri në nëntor 2004 dhe se refuzimi i kërkesës së tij me vendim është i papranueshëm për të dhe se nuk ka mundur të informohet dhe të kuptoj më shumë lidhur me të drejtat e tij si dhe të ndërmarr masa sa i përket këtyre të drejtave. Në mbështetje të ankesës, ankuesi dorëzoi vetëm një kopje të vendimit të kundërshtuar.

Me 19 shkurt 2016, e paditura parashtroi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka saktësuar se cili Nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga ana e AL në nxjerrjen e vendimit, në kundërshtim me Nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon që ankesat e parashtruara në DHPGJS kundër vendimeve të AL “*duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L-034 për AKP-në*”. Pretendimi se vendimi është thjesht i papranueshëm për ankuesin nuk përbën provë apo argument të mjaftueshëm ligjor për të lejuar ankesën, e cila si e tillë është e papranueshme. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit ankuesi ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK dhe Neni 23 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033). Një rregull i tillë është shprehimisht i sanksionuar edhe në nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Pasi konstatoi që nuk kishte informata dhe dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur kërkesën, me datë 05 korrik 2013, AL i ka dërguar letër ankuesit përmes së cilës i kërkohet të dorëzoj informata shtesë në mbështetje të ankesës së tij dhe se pas përgjigjes nga ankuesi, AL vlerësoi se informacioni i dhënë në përgjigje i mundëson shqyrtimin e mëtejshëm. Duke qenë se ankuesi në përgjigje përcaktoi se nga prill 1999 ishte larguar nga Kosova dhe kërkesa i referohej pagave të papaguara nga ajo kohë deri në nëntor 2004, AL në zbatim të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 konkludoi se kërkesa ishte e parashkruar. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se: “*elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”. Neni 37.4.1 i kësaj Shtojce parashikon se “*Kërkesat që konsiderohen të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi*”. Neni 608 i LPB parashikon se “*pagesa e pagës apo rrogës, apo çdo lloj tjetër kërkesë e punëtorit që buron nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet*”. Parashtruesi nuk kishte ndërmarr asnjë veprim ligjor brenda tre viteve nga prill 1999, periudhë prej të cilës nuk punoi më për NSH-në dhe për rrjedhojë nuk pranoi paga nga e njëjta. Rrjedhimisht kërkesa për paga të papaguara u parashkrua në prill 2002. E paditura më tej pohoi se afati i parashkrimit nuk i lejon AL dhe/ose DHPGJS të analizojë dhe shqyrtojë meritat e rastit. DHPGJS e ka mbështetur këtë arsyetim juridik përmes praktikës ligjore, prandaj vendimi i vetëm që mund të merret në këtë rast është kërkesa është parashkruar. E paditura më tej theksoi se ankuesi edhe vet në kërkesën e tij e ka pranuar se nga 1999 ishte larguar nga Kosova dhe rrjedhimisht nuk kishte punuar për NSH-në. Vlen të theksohet se pagesa e rrogave nga NSH-ja nuk përbën asistencë sociale. Në fakt paga është kompensim për punën e kryer, në zbatim të një kontratë dypalëshe përmes së cilës rregullohen të drejtat e tyre si dhe palët përmbushin detyrimet që rrjedhin nga e njëjta NSH. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033. E paditura në mbështetje të ankesës së saj dorëzoi në kopje dëshmitë si: Kërkesën për ndërrimin e anëtarëve të AL datë 22 dhjetor 2015, Kërkesën e AL për dëshmi dhe informacione shtesë dhe Përgjigjen e ankuesit ndaj kërkesës së AL së bashku me dëshmitë përkatëse të ankuesit.

Me 24 mars 2016, ankuesi dorëzoi përgjigjen e tij (në dorëshkrim) në mbrojtjen e të paditurës.
Me 13 maj 2016, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetime ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. GJI065-0543, datë 18 dhjetor 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 20,000.00 € për një periudhë të pacaktuar kohore, nga NSH “Vinex” (*në likuidim*). Në ankesën e tij kundër vendimit të kundërshtuar ankuesi kërkon kompensim për paga të papaguara për periudhën prill 1999 – nëntor 2004, në shumën e njëjtë.

Në lidhje me kërkesën për pagat e papaguara për periudhën e lartcekur (prill 1999 – nëntor 2004), ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante që dëshmon ekzistencën e marrëdhënies së tij të punës me NSH dhe as dëshmi të tjera në lidhje me përvojën e tij të punës apo çfarëdo dokumenti apo listë të punëtorëve që do të mund të dëshmonte kohën e saktë të punësimit dhe stazhin e tij të punës respektivisht momentin kur është punësuar dhe për sa kohë ka qenë punëtor i NSH-së. Dëshmitë e vetme të dorëzuara në këtë rast nga ankuesi janë vendimi i kundërshtuar dhe disa dëshmi të tjera mbështetëse rreth të hyrave mesatare për periudhën kohore objekt kontesti dhe atë në Republikën e Serbisë, por të cilat nuk janë relevante për themelësinë e kërkesës së ankuesit për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti tek NSH. Nga shkresat e lëndës gjykata gjen

se ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante as në procedurën e likuidimit tek AL, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij në lidhje me pagat e papaguara si dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shumën mujore e as lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara në shumën totale prej 20,000.00 €. Ankuesi edhe vet ka deklaruar se nga viti 1999 ishte larguar nga Kosova dhe rrjedhimisht nuk ka punuar në NSH.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara për periudhën kohore prill 1999 – nëntor 2004, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara mbi bazën e asaj se nuk ka mund të informohet lidhur me të drejtat e tij si dhe të ndërmarr masa sa i përket atyre të drejtave, por gjen se të njëjtat janë vetëm pretendime përgjithëse dhe si të tilla nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, prandaj dhe refuzohen.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 8.1.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, aprovohet kërkesa e ankuesit për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore për ankesën e parashtruar pasi që i njëjti është në gjendje jo të mirë ekonomike.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar